



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 dhjetor 2014
Nr. ref.: RK741/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI143/14

Parashtrues

Ferbend Haxhiaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 26/2012, të
16 shtatorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ferbend Haxhiaj, qytetar i Republikës së Shqipërisë, me vendbanim në Durrës, Republika e Shqipërisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 26/2012, të 16 shtatorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 11 nëntor 2013.
3. Gjykata tashmë kishte nxjerrë një vendim për çështjen e njëjtë në rastin KI28/14, parashtrues të kërkesës *Skender Mezini dhe Ferbend Haxhiaj*, Aktvendim për papranueshmëri, nxjerrë më 19 maj 2014, dhe publikuar më 13 qershor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të njëjtë të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 1 [Mbrotjtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës nuk saktëson se cilat dispozita të Kushtetutës janë shkelur.

Baza juridike

5. Baza juridike e kërkesës është: neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji)

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 7 tetor 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 21 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 19 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesën KI143/14, pa paraqitur ndonjë fakt dhe provë të re lidhur me procedurën e përfunduar në gjykatat e rregullta dhe në Gjykatën Kushtetuese.
11. Në të vërtetë, më 10 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës, së bashku me z. Skender Mezini, kishin dorëzuar në Gjykatë kërkesën KI28/14, me të cilën kishin kontestuar të njëjtin Aktgjykim të Gjykatës Supreme (Rev. nr. 26/2012, të 16 shtatorit 2013).

12. Ndërkohë, më 19 maj 2014, Gjykata deklaroi kërkesën KI28/14 të papranueshme, pasi ishte qartazi e pabazuar (Rasti KI28/14, Aktvendim për papranueshmëri, publikuar më 13 qershor 2014).
13. Faktet dhe vendimet e Gjykatës të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës në këtë kërkesë të re KI143/14 tashmë janë shqyrtuar në rastin nr. KI28/14, siç është vendosur me Aktvendimin për papranueshmëri, të 19 majit 2014.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi në kërkesën e re KI143/14 këmbëngul në pretendimin se aktgjykimi i kontestuar e ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.
15. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht të drejtën e tij si trashëgimtar i paraardhësve të tij të cilët ishin lindur në Kosovë për t'u bërë shtetas të Republikës së Kosovës, dhe për të gëzuar të drejtën e pronësisë mbi pronën e paluajtshme të paraardhësve të tij.
16. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk specifikon saktësisht dispozitat e Kushtetutës, të cilat pretendohet se janë shkelur. Në vend të kësaj, ai i referohet neneve 3, 4 dhe 5 të Ligjit për të Drejtat e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë Nr. 03/L-95 (publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 10 dhjetor 2010).
17. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata që t'i mundësojë atij që si trashëgimtar të gëzojë të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme të paraardhësve të tij.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve], i cili përcakton:
“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës..”.
20. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 63 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:
“Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”.
21. Për më tepër, rregulli 36 (3) d) i Rregullores së punës parasheh:

“Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: (...) e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri”;

22. Gjykata konsideron që faktet dhe pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e re nuk paraqesin bazë e as arsye të mjaftueshme e relevante për një vendim të ri (Shih, Gjykata Kushtetuese Rasti KI02/14, parashtrues i kërkesës *Hamdi Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 majit 2014).
23. Në të vërtetë, Gjykata përkujton që tashmë është marrë me çështjen e përmendur në rastin KI28/14, parashtrues të kërkesës *Skender Mezini dhe Ferbend Haxhiaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i nxjerrë më 19 maj 2014. Në aktvendimin e saj, Gjykata kishte deklaruar kërkesën të papranueshme, për shkak se ishte qartazi e pabazuar sepse faktet e paraqitura nga parashtruesit e atëhershëm të kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetuan pretendimin e tyre për shkeljen e të drejtave kushtetuese, dhe parashtruesit nuk kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme si dhe pse aktgjykimi i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.
24. Në këtë mënyrë, Gjykata konstaton që tashmë ka marrë vendim për çështjen në fjalë dhe se kërkesa nuk përmban bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.
25. Prandaj, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, rregullin 63 (1) dhe rregullin 36 (3) e të Rregullores së punës, Gjykata konkludon se kjo kërkesë duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 63 (1) dhe 36 (3) d) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2014, njëzëri


VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani